



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 826/8 prot.

Tiranë, më 01.10.2019

VENDIM
Nr.91, datë 01.10.2019

PËR
PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 86, DATË 17.07.2019

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 86, datë 17.07.2019, “Për plotësimin e aktit nr. 5148/3 prot., datë 14.5.2019, për lirim nga shërbimi civil, të nëpunëses *****”,

KONSTATOVA SE:

Nëpërmjet informacionit të ardhur nga punonjësja ***** , regjistruar me nr.826 prot., datë 17.05.2019, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil është vënë në dijeni, lidhur me pretendimet e saj, për parregullsi gjatë procesit të ristrukturimit të Drejtorisë Arsimore Rajonale Vlorë, nga ana e Komisionit të Ristrukturimit, i cili nuk i ka ofruar ndonjë pozicion tjetër në shërbimin civil, sikurse parashikohet nga neni 50, i ligjit 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe në vendimin nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, por ka vendosur lirim nga shërbimi civil.

Për verifikimin e informacionit, Komisioneri, ka nisur hetimin administrativ për rastin në fjalë duke analizuar të gjithë procedurën e ndjekur nga Komisioni i Ristrukturimit, gjatë procesit të ristrukturimit të institucionit Drejtoria Arsimore Rajonale Vlorë, si dhe dokumentacionin e përpiluar nga Komisioni gjatë këtij procesi.

Në përfundim të hetimit administrativ procesi është përmbyllur me Vendimin Nr. 86, datë 17.07.2019, “Për plotësimin e aktit nr. 5148/3 prot., datë 14.5.2019, për lirim nga shërbimi civil, të nëpunëses *****”, në të cilin është vendosur:

*“1. Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si organi pjesëmarrës në kryerjen e procesit të ristrukturimit që ka nxjerrë aktin nr. 5148/3, datë 14.05.2019, për lirim nga shërbimi civil të nëpunëses *****”, ta plotësojë atë me përmbajtjen e tekstit të pikës 8, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.”*

Në vijim, Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, me shkresën nr. 7254/4 prot., datë 28.08.2019, “Dërgohet informacion”, protokolluar pranë Komisionerit me nr. 1045/7 prot., datë 02.09.2019, ka vënë në dijeni këtë të fundit, në lidhje me masat e marra, për zbatimin e rekomandimeve të lëna në dispozitivin e Vendimit Nr. 86, datë 17.07.2019, “Për plotësimin e aktit nr. 5148/3 prot., datë 14.5.2019, për lirim nga shërbimi civil, të nëpunëses *****”, si dhe ka nënvizuar faktin se në Vendimin nr. 4980/176 prot., datë 08.05.2019, të Komisionit të Ristrukturimit, rekomandimet e dhëna nga Komisioneri, janë të cituara, por në vendimin e nxjerrë nga njësia e burimeve njerëzore të MASR nuk janë cituar, për efekt mos përsëritje të akteve.

Në analizë të praktikës shkresore të këtij rasti, vërej se:

Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, me shkresën nr. 7254/2 prot., datë 28.08.2019, me objekt : “Vendim për një shtesë dhe ndryshim në vendimin për lirim nga shërbimi civil nr. 5148/3, datë 14.05.2019 për *****”, në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore të dala për menaxhimin e shërbimit civil, të Vendimit nr. 4980/176 prot., datë 08.05.2019, të Komisionit të Ristrukturimit, si dhe Vendimit nr. 86, datë 17.07.2019, të Komisionerit për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil, ka vendosur:

“1. Pika 2 e vendimit nr. 5148/3, datë 14.05.2019 të ndryshojë si më poshtë vijon:

a) Nëpunësi trajtohet sipas pikës 7, të nenit 50, të ligjit 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

b) Nëpunësit civilë, të cilët janë larguar nga shërbimi civil, si pasojë e ristrukturimit apo mbylljes së institucionit, kanë të drejtë që, brenda periudhës 2-vjeçare pas përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil:

1. të konkurrojnë si nëpunës civilë për procedurat e lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, sipas neneve 25 dhe 26 të këtij ligji;

2. të emërohen në mënyrë të përkohshme nga njësia përgjegjëse, me pëlqimin e tyre, në pozicione të shërbimit civil.

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar dhe Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar për zbatimin e këtij vendimi.”

Për sa u parashtrua më sipër, arrij në përfundimin se nga ana e Drejtorisë së Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve në Ministrinë e

Arsimit, Sportit dhe Rinisë janë zbatuar rekomandimet e lëna në Vendimin Nr. 86, datë 17.07.2019, *“Për plotësimin e aktit nr. 5148/3 prot., datë 14.5.2019, për lirim nga shërbimi civil, të nëpunës *****”*, të Komisionerit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 86, datë 17.07.2019, *“Për plotësimin e aktit nr. 5148/3 prot., datë 14.5.2019, për lirim nga shërbimi civil, të nëpunës *****”*.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e Drejtorisë së Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, duke zbatuar rekomandimet e Vendimit Nr. 86, datë 17.07.2019.
3. Për këtë vendim të njoftohet Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Departamenti i Administratës Publike dhe nëpunësja *****.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha